

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE-DEGA NE PODUJEVE, Departamenti I**

**Pergjithshem-Divizioni civil** si gjykat e shkalles se pare, e perbere me gjyqtarin Binak Duqi, dhe sekretaren juridike Xhevide Selmani, ne qeshtjen juridike te paditesit B.B.nga P. rruga “...” pa nr. te cilin e perfaqeson Z.Xh.avokat nga P. me autorizim kunder te paditurve M.P. ish nga P. tani me vendbanim ne K. rruga “...” nr.. S. dhe Komuna e Podujeves te cilen e perfaqeson Faik Rama me autorizim, per anulim te kontrates-privatizimin e baneses, ne shqyrtimin kryesor, publik, te mbajtur ne pranine e te autorizuarit te paditesit, te paditurit te pare dhe te perfaquesuesit te paditures se dyte me date 25.02.2014 mori kete:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar padia dhe kerkesepadia e paditesit B.B.nga P., me te cilen ka kerkuar qe te “anulohet kontrata mbi shitblerjen-privatizimin e baneses e lidhur ne mes te paditurit M.P.dhe perfaquesuesve te komunes VR. Nr.338/1993 date 02.08.1993 e cila gjendet ne P. rruga “...”me siperfaqe prej 57.54 metra katror, e cila evidentohet ne emer te paditurit M. P., si dhe te konsiderohen nule te gjitha pasojat qe I ka prodhuar kjo kontrate”.

Obligohet paditesi qe te paditurit te pare tia kompenzoj shpenzimet e procedures kontestimore ne shume prej 85 euro ne afat prej 15 ditesh pas pranimit te këtij aktgjykimi nen kercenim te permbarimit me dhune.

**A r s y e t i m**

Paditesi B.B.nga P. ne kete gjykat ka ngritur padi nepermes te autorizuarit te tij Z.Xh.avokat nga Prishtina me dt.10.09.2010, e me te cilen ka kerkuar anulimin e kontrates-per privatizimin e baneses e cila gjendet ne Podujeve rruga “...”me siperfaqe prej 57.54 metra katror. Kjo kontrate eshte e lidhur ne mes te paditurit M.P.dhe perfaquesuesve te Komunes se Podujeves me numer VR.338/1993 date 02.08.1993. Sipas paditesit atij I eshte ndare kjo banese nga ana e kuvenit te Komunes se Podujeves e krejt kjo sipas ligjit mbi mardheniet banesore me aktvendimin 04 nr.6028 date 18.05.1967 ne shfrytezim. Me pastaj ka lidhur kontrate me BWI-n e athershme per banim me nr.44/18 date 15.05.1979. Mirepo me instalimin e pushtetit okupues serb I cili I shfyqizoi te gjitha ligjet e Kosoves dhe nga puna I largoi te gjithe punetoret shqiptar, mbi bazen e diskriminimit nacional.

Nderkohe paditesi ishte ftuar me ftese per mobilizim ne radhet e ushtrise serbe dhe ai me kete rast detyrohet te largohet nga vendi I punes dhe Kosova. Paditesi ishte puntor I kuvendit te Komunes se Podujeves. Por me vone e njejta banese I eshte ndare te paditurit nga Komuna e Podujeves sipas aktvendimit te saj nr.04-360-83 date 19.11.1992. I padituri kete banese e privatizon (blen) dhe kontraten e verteton ne Ggjykaten Komunale ne Podujeve nr.VR 338/93 date 02.08.1993.

Paditesi mendon se kjo kontrate mbi privatizimin e baneses eshte e pavlefshme sepse e njejtë eshte e lidhur ne baze te ligjeve diskriminuese te pushtetit serb. Ajo eshte nule dhe nuk mund te prodroj efekte juridike.

Paditesi nepermes te autorizuarit te tij ne seanca dhe fjalen perfundimtare gjate shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetem prane padise dhe kerkesepadise se precizuar te dates 30.12.2013 ne procesverbal te gjykates. Me kete rast ka bere precizimin e kerkesepadise duke I shtuar anulimit te kontrates edhe pjesen per privatizimin e banesës duke kerkuar ne kete rast qe gjykata ta anuloj kontraten ne fjale sepse eshte e kunderligjshme dhe ne kundershtim me te gjitha dispozitat ligjore pozitive te ligjit ne fuqi. Ne seancen e dates 03.12.13 ka bere zgjerimin e padise duke perfshire si te padituren e dyte edhe komunen e Podujeves.

Me tutje paditesi nepermes te autorizuarit te tij ka shtuar se ai ka qene puntor I paditures se dyte komuna e Podujeves mbi 30 vite dhe ate prej vitit 01.10.1961 deri me 01.07.90 dhe per kontributin e tij ne pune I eshte ndare banesa kontestuese ne shfrytezim.

Sipas ligjit te KSAK te athershem mbi mardheniet banesore nen 2 I tij thuhet se shfrytezuesi e humb te drejten e shfrytzimit te banesës nese e lehon mardhenien e punes ku ai punon, nuk e shfrytzon banesen dhe nese e shfrytzon ne kundershtim me kushtet e parapara ligjore. Por keto rregulla nuk vlejn per paditesin dhe per personin I cili shfrytezon banesen me teper se 10 vite e paditesi ne kete rast e ka shfrytuar te njejtin afer 30 vite, prandaj nuk ka mundur ti merret banesa mbi asnje baze.

I padituri I referohet nje aktgjykimi Gjykates Supreme te Kosoves te vitit 1993 sepse me pare organi administrative I komunes kishte marre vendim qe paditesi ta liroj banesen me vendimin e saj 04.04.1983 per te ashtuquajturen parolle komuniste “ke shtipi, ke banesen”, e cila ka qene pa baze ligjore dhe me ate baze paditesi detyrohet me vendim te paditures se dyte ta liroj banesen. Paditesi me padi ka filluar prane Gjykates Supreme te Kosoves konfliktin administrativ mirepo duke qene se edhe ajo gjykate ishte ne sherbim te politikes komuniste e refuzon padin e paditesit dhe e verteton vendimin e organit administrative te shkalles se dyte. Sipas tij edhe ky vendim I Gjykates Supreme te Kosoves ishte ne sherbim te politikes komuniste. Por edhe pas ketyre vendimeve paditesi nuk e ka liruar banesen.

Sa I perket vendimit te Habitatiit pala paditese ka deklaruar se ky eshte nje organ hibrid dhe se Habitati mbi bazen e kontrates e cila ishte e lidhur ne menyre te kunderligjshme te paditurit ia pranon te drejten e banesës.

Krejt ne fund ka deklaruar se kerkesepadia e paditesit eshte teresisht e bazuar dhe I ka propozuar gjykates qe kontraten e lidhur ne mes te paditurit te pare dhe te paditures se dyte ta anuloj, e paditesit ti kthehet e drejta ne banesen kontestuese.

Shpenzimet e procedures I kerkon sipas TA per tri seanca dhe padi.

I padituri I pare M.P.ne pergjigje ne padi te dates 24.09.13, seanca dhe fjalen perfundimtare gjate shqyrtimit kryesor e ka kontestuar ne teresi padin dhe kerkesepadin e paditesit si te pa bazuar. Me tutje ka deklaruar se une jam pronar I banesës e cila gjendet ne P. rruga “...” ish APJ nr..... me numer banese 6 me siperfaqe perafersisht prej 58 metra katror e cila me eshte ndare me vendim te komunes nr.04-360-83 te dates 19.11.1992. Te njeften banese e kam blere dhe kontraten e kam vertetuar ne gjykaten kommunale ne Podujeve 01 nr.360-89 date 19.03.93 me

numer VR 338-93. Poashtu me vendimin e Gjykates Supreme te Kosoves AGJ nr 487-83 dates 08.07.93 I ka kerkuar qe paditesi ta leshoj banesen dhe te shperngulet nga ajo. Gjithashtu Habitati me vendimin e shkalles se dyte HPCC dates 06.09.2006 mua ma ka njoftur te drejten e baneses dhe e ka vertetuar vendimin e shkalles se pare e qe tani ky vendim e ka marre formen e prere. Kam kerkuar ndihmen nga Agjensioni Kosovar I Prones e cila ka marre mandatin nga HPCC dhe e ka perfunduar rastin me 19.01.2007 duke e shperngulur me dhune paditesin nga banesa dhe duke mi dorzuar qelsat e saj.

Poashtu me aktgjykimin P.Nr.118/07 date 12.01.2011 paditesi B.B. eshte shpallur fajtor per thyerjen e kesaj banese dhe prishjen e vules zyrtare ne deren e baneses sime. Banesen e kam te fituar nga mardhenia e punes sepse ai eshte I lindur ketu ne P. fshat I komunes se P. dhe eshte banor I ketuhit edhe pse momentalisht nuk jetoj ketu per shkaqe te njohura.

Un me ndihmen e Policis se Kosoves ne prill te vitit 2007 jam vodosur ne banese mirepo paditesi e ka thyer ate prap per te treten here dhe ka hyre ne te ne menyre te kunderligjshme me 29.10.2008. Prandaj banesen e kam blere ne menyre te rregullt dhe ajo evidentohet ne emrin tim prandaj I propozoj gjykates qe padin e paditesit per anulim te kontrates ta refuzoj ne teresi si te pabazuar.

Shpenzimet e procedures I kerkoj per qdo séance nga 30 euro fjala eshte per shpenzimet e rruges.

Perfaqesuesi I te paditures se dyte komuna e Podujeves Faik Rama ne pergjigje ka deklaruar se ne jemi ne dijeni qe ka qene nje ligj sipas te cilit eshte thene se ke shtepi, kthe banesen dhe mu per kete shkak edhe Gjykata Supreme e Kosoves ia ka mohuar te drejten paditesit B.B.. Gjithashtu jam ne dijeni se ai ka pasur shtepi mirepo ate ia ka zene vellau I tij ne menyre arbitrale kurse ky e ka shfrytezuar banesen gjer me 1992.

Sa I perket vendimit te komunes se a ka qene diskrimin kur ai ka shitur banesen te paditurit te pare kete ia le ta vlersoj gjykata.

Shpenzimet e procedures nuk I kerkoj.

Gjykata per te vertetuar drejte gjendjen faktike ne kete qeshtje kontestimore lidhur me pretendimet e paleve padite se ne procedure e proves beri administrimin dhe leximin e ketyre provave: u lexua procesverbali I kesaj gjykate C.nr 471/10 dates 30.12.13, u lexua aktgjykimi I Gjykates Komunale ne Podujeve C.nr 313/05 date 29.12.2009, shkresa e koordinatorit per te drejtat pronesore te Eulex-it drejtuar te paditurit te pare date 21.12.2011, aktvendimi I Gjykates se Qarkut Prishtine A C.nr 506/2007 date 28.09.2007, aktvendimi I GJQP Prishtine A C.nr 935/10 dates 24.01.2012, procesverbali mbi pranim dorzimin e baneses ne shfrytezim date 27.11.1992, lajmerimi I sekretariatit per ekonomi dhe urbanizem-qeshtje per veprimitari komunale banesore numer 04-360-597 dates 04.06.1992, pergjigja ne padi e te paditurit M.P.24.09.2013, vendimi mbi dhenien e baneses ne shfrytezim nr.04-36-083 date 19.11.1992, kontrata mbi blerjen e baneses 01 nr.360-89 dates 11.03.1993, deftesa mbi pagesen per banesen e blere nga I padituri e vertetuar ne komunes e Podujeves me nr.338/93 dates 02.08.1993, Agjensioni Kosovar per prona per statusin e lendes DS 3011043, protokoli mbi dorezimin e qelsave-fletetorezimi date 05.01.2007, vendimi I vertetuar per numrin e lendes DS 005382 vendim nga Habitati, vendimi I vertetuar sipas kerkeses per rishqyrtim nga Habitati, vendim lidhur me kerkesen per shqyrtim te serishem HPCC/REK/71/2006 dates 06.09.2006, aktgjykim I

GJSK (Gjykata Supreme e Kosoves) AU nr.487/83 dates 08.07.1983, aktvendim I GJQP ne Prishtine GZ/AC nr.506/2007 dates 28.09.2007, aktvendim mbi revizionin nr.1/2008 I GJSK dates 15.04.2009, aktvendim I gjykates komunale ne Podujeve N nr.129/2005 dates 07.07.2007, aktgjykim-urdher ndeshkimor I gjykates komunale ne Podujeve P. nr.118/2007 dates 12.01.2011, aktvendim I Gjykates Themelore Prishtine-Dega Podujeve C. nr.471/10 dates 30.01.2013 ne gjuhen Shqipe dhe serbe, aktvendim I Gjykates se Apelit te Kosoves CA nr.545/13 dates 19.06.2013, vendim nga kuvendi komunal Podujeve-sekretariati per ekonomi dhe financa nr.04-6028 date 18.05.1967, kontrate mbi shfrytzimin e baneses nr.44/18 dates 15.05.79, aktvendim I GJSK-s REV 1/2008 dates 15.04.2009, ankesa e paditesit kunder aktvendimit I GJTHP- Dega Podujeve C nr.471/10 dates 05.02.13, llogaritje per vertetimin e qmimit kontraktues per blerjen e baneses nr.168 date 11.03.1993, adresa e prones kerkesa nr.DS 005382 dhe DS 3001043, vertetim nga ndermarrja publike per banim Podujeve nr.09/01.02.2008, vertetim nga komuna e Podujeves nr.865 dates 31.10.2005, deshmi e pageses se qiras nr.33 date 19.04.2007, nje proces ne te cilin jane shenuar banoret nga pala padite se te cilet kane qene sipas tij banore ne hyrjen e paditesit duke filluar me numrin rendor 1 deri 28, vertetimi I dates 21.03.83 nga bashksia lokale, thirrje dhe vertetim per paditesin per mobilizim ne forcat ushtarake serbe pjese nga ligji I nxjerre nga fletorja zyrtare I KSAK mbi mardheniet banesore I dates 31.07.73, vendimi numer 04-360-811 dates 15.03.91, kontrate mbi pagesen per mirmajtjen e baneses nr.630 dates 02.08.93.

Pjeserisht me verejtje nga pala padite kurse pala e paditur 1 dhe 2 pa verejtje ne administrimin e provave.

Pasi qe gjykata beri vlersimin e provave me ndergjegjie nje nga nje I te gjithave se bashku conform nenit 8 te LPK-se gjeti se kerkesepadia e paditesit eshte e pabazuar dhe si te tille e refuzoi siq eshte cekur ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Nuk eshte kontestuar se per gjykaten se te paditurit M.P. me aktvendim te paditures se pare komuna e Podujeves me date 19.11.1992 nr. 04-360-83 nga drejtoria per ekonomi, financa, urbanizem, pune komunale banesore dhe mardhenie pronsore juridike iu ka ndare banesa ne shfrytezim. Sipas aktvendimit I padituri merr banesen si puntor I te paditures se dyte ne shfrytzim e cila banes gjendet ne rrugen ish JNA tani “...”me siperfaqe siq eshte cekur ne dispozitiv te aktgjykit ne prorsi shoqerore pronar I se ciles eshte komuna e Podujeves.

I padituri ka lidhur kontrate me te padituren e dyte me 01. Nr.360-89 me date 11.03.93 per blerjen e kesaj banese-privatizimin e saj me qmim prej 217.929 ish dinare te athershem per metren katror e gjithsejt ne Shumen prej 2.616.888 dinare.

Per gjykaten nuk eshte kontestuar se I padituri M.P.e ka bere pagesen per blerjen e baneses ne teresi kjo vertetohet nga deftesat e sherbimit te kontabilitetit shoqeror (SHKSH) te cilat deftesa gjenden ne shkresat e lendes nr.38240 dates 17.03.93.

Eshte jo kontestuese se paditesit B.B. komuna e Podujeves si e paditura e dyte me aktvendimin e saj 04-6028 date 18.05.67 ia ka ndare banesen kontestuese ne shfrytezim paditesit me pagesen e qiras mujore kjo vertetohet nga aktvendimi I paditures se dyte.

Eshte jo kontestuese se me kontraten e lidhur ne mes paditesit dhe te paditures se dyte komuna e Podujeves nr.44/18 date 15.05.79 kane lidhur kontrate se bashku qe banesen ta merr ne shfrytezim paditesi.

Eshte jo kontestuese se paditesi banesen e ka mbajtur qe nga 18.05.1967 deri 17.11.1992 e kjo vertetohet nga prova vertetimi I leshuar nga ish ndermarrja publike per banim ne Podujeve nr.091 dates 01.02.2008.

Eshte jo kontestuese se paditesi B.B. ka qene puntor I komunes se Podujeves prej dates 01.10.61 deri 01.07.90 kjo vertetohet nga vertetimi I leshuar nga komuna e Podujeves nr.865 dates 30.10.2005. Poashtu eshte jo kontestuese se I njejti e ka paguar qirane e baneses per shfrytezimin e saj per periudhen 1982-1992 deshmi e saj eshte deshmia numer 33 date 19.04.2007.

Nga prova fleta e nenshkruar nga banoret te cilet banojn aty ne hyrjen e paditesit siq kane deklaruar ata e cila eshte nenshkruar si deshmi kjo kontestohet nga I padituri sepse sipas tij ne ate objekt asnjehere nuk ka pasur kaq shume banues dhe se aty kane jetuar vetem 4 familje shqiptare kurse keta te tjeret nuk jane banore fare aty. Aty kane qene vetem 9 banesa e jo 28 persona te nenshkruar siq eshte ne kete deshmi prandaj kjo nuk eshte e vertete fare dhe e kontestoj validitetin e saj por kete as gjykata nuk e vleroi si prove te besueshme dhe nuk e fali besimin si e tille.

Kontestuese ne kete queshtje kontestimore ishte se kontrata e lidhur ne mes te paditurit M.P. dhe te paditures se dyte komuna e Podujeves a ishte e kunderligjshme siq pretendon pala paditese dhe se e njejta eshte marre ne baza diskriminuese nga pushteti I athershem serb dhe ne kundershtim me dispozitat ligjore ne fuqi gjithashtu a ka baze per anulimin e kesaj kontrate.

Sipas mendimit te gjykates ne kete rast nuk behet fjale per kontrate te kunderligjshme dhe te marre ne baze te diskriminimit sepse faktet dhe provat e vertetuara gjate procedures e te cilat u administruan me kujdes dhe ne menyre te gjithanshme e deshmojne te kunderten e saj.

Se I padituri M.P.e ka fituar te drejten mbi banesen kjo eshte sipas aktvendimit te komunes se Podujeves me nr.04-360-83 dates 19.11.1992 e cila edhe eshte e vertetuar ne gjykaten komunale ne Podujeve me numer kontrate VR nr.338/1993 date 02.08.1993. Pastaj e paditura me procesverbalin e dates 17.12.1992 nr.516 mbi ndarjen ne shfrytzim te baneses duke vendosur lidhur me te drejten per blerje te baneses paditesin e ka njoftuar duke ju drejtuar atij qe ne afat prej 11.06 deri 25.06.1992 te sjelle dokumentacionin per blerjen e kesaj banese mirpo paditesi nuk eshte lajmruar Brenda ketij afati te caktuar ne procesverbal.

Te drejten mbi banesen si pronar paditurit ja ka njoftur dhe validitetin e privatizimit te saj edhe Habitati kur e ka vertetuar vendimin e shkalles se pare te komisionit per mardhenie pronsore banesore me numer rasti DS 005382 dhe DS 301043 ne vendimin e saj te marre grupor HPCC/D/208/2005 date 20.08.2005 nga komisioni per kerkesa pronsoro-juridike.

Me kerkesen e paditesit drejtuar Habitatis per rishqyrtimin e ketij vendimi te njejtit I eshte refuzuar kerkesa nga shkalla e dyte- Habitati me vendimin grupor te saj HPCC/REK/71/2006 date 06.09.2006-komisioni per kerkesa pronsore banesore.

Se eshte vertetuar si pronar I ligjshem I baneses I padituri kete me se miri e verteton edhe protokoli mbi dorzimin e qelsave-fletedorzimi I Habitatis I bere me date 05.01.2007 me nr. rasti DS 301043.

Edhe vendimi I Gjykates se Qarkut Prishtine AC nr.935/10 dates 24.01.2012 edhe perkunder asaj se e ka aprovar kerkesen e paditesit B.B. ka deklaruar se aprovon ankesen per shkak se nuk iu

dorezuar te autorizuarit te paditurit B.B. ftesa personalisht mirepo ka bere konstatimin se e pranon faktin se vendimi perfundimtar per banesen eshte marre nga HPCC/REK/71/2006 date 06.09.2006 e qe me ate rast iu ka njojur e drejta te paditurit M.P.e drejta e pronesis ne banesen kontestuese.

Me aktgjykimin-urdhrin ndëshkimon P nr.118/07 te Gjykates Komunale ne Podujeve gjykata vertetoi se paditesi B.B. eshte shpallur fajtor per vepren penale falsifikim te dokumentave nga neni 332 par.1 dhe 3 te KPK-se dhe I njejti eshte denuar me gjobe pasi qe e ka demtuar cilindrin e deres se baneses dhe hequr bllampen-shenjen zyrtare te cilen e ka vendsur personi zyrtar I HPD-Habitatit.

Eshte e vertete se paditesi B.B. e ka shfrytezuar banesen ne fjale mirepo me nxjerrjen e ligjit ke shteki, kthe banesen atij I eshte mohuar e drejta ne ate banes dhe eshte marre vendimi nga organi kompetent qe ai ta kthej ate andaj edhe po qese e ka mbajtur banesen duke shfrytzuar per gjykaten nuk eshte me rendesi sepse prej momentit kur eshte marre vendimi per tu larguar nga banesa dhe kthimin e saj-lirimin ai banesen e ka mbajtur ne menyr te kunderligjshme dhe ne menyre jo ligjore ka qendruar ne te.

Kjo me se miri vertetohet nga aktgjykimi I Gjykates Supreme te Kosoves AU nr.487/83 date 08.07.1983 ku kolegji ne perberje te se cilit kane qene te gjithe shqiptare dhe nuk mund te thuhet se ai vendim eshte marre me baza diskriminuese por as pretendimi I paditesit se vendimi I marre eshte politik dhe ne sherbim te politikes komuniste me prallen komuniste siq e quan pala paditese ke shteki kthe banesen por ky vendim eshte I drejte.

Me padin e paditesit B.B. I cili ka nisur konfliktin administrative ne Gjykaten Supreme te Kosoves kunder aktvendimit te shkalles se dyte ish komitetit krahinor per urbanizem, pune komunale dhe banesore ne Prishtine, 03 nr.360-235/83 dates 12.05.83 per lirim banese Gjykata Supreme e Kosoves ne kete rast e ka refuzuar padin e paditesit B.B. me te drejte duke theksuar se paditesi ka shteki ne Podujeve ne nje siperfaqe prej 220 metra katror andaj e ka konstatuar se organi administrativ I shkalles se dyte ja ka refuzuar me te drejt ankesen e paditesit kunder vendimit te shkalles se pare komuna e Podujeves dhe se ky vendim eshte ne harmoni me dispoziten e nenit 14 te ligjt mbi mardheniet banesore te ish KSAK dhe nenit 4 te ligjt mbi ndryshimin dhe plotesimin e ketij ligji.

Andaj te gjitha provat e ofruara nga pala paditese, deklarimet e tija dhe pretendimet ne séanca gjate shqyrtimit kryesor gjykata gjeti se ato pretendime nuk kane ndikuar me marre vendim tjeter qfare eshte marre dhe siq eshte cekur ne dispozitiv te ketij aktgjykimi per refuzimin e padis dhe kerkesepadise si te pabazuar dhe pa vertetuar me prova ne procedure. I padituri I pare me te drejte te kundershtoj dhe deklaroj se eshte pronar legitim I baneses ne fjale dhe se nuk ka asnje baze apo prove qe te anuloj kete kontrate gjykata per privatizimin e baneses sepse ajo eshte ligjore e kete ai ka njoftur edhe Habitati organ I kombeve te bashkume I cili ka pasur supermacion dhe vendimet e saja nuk kan mundur te rishqyrtohen nga organet vendore te gjygjse.

Prove mjaft me rendesi per vendosjen ne favor te pales se paditur dhe kunder asaj paditese edhe aktgjykimi I gjykates komunale ne Podujeve C nr.313/05 date 29.12.2009 ku e ka refuzuar kerkesepadin e paditesit B.B. me te cilin ka kerkuar vertetimin e te drejtes se pronesis si te pabazuar.

Poashtu aktvendimi I Gjykates se Qarkut ne Prishtine AC nr.506/07 date 28.09.2007 e cila e ka aprovuar ankesen e kunderpropozuesit M.P.si te bazuar dhe e ka ndryshuar aktvendimin e gjykates komunale ne Podujeve N nr.129/05 dates 07.07.2005 duke refuzuar propozimin e propozuesit per mase te perkohshme poashtu me rendesi eshte edhe aktvendimi I gjykates themelore ne Prishtine- Dega Podujeve C nr.471/10 date 30.01.13 me qast eshte refuzuar propozimi I paditesit per caktimin e mases se perkohshme si I pabazuar dhe I cili vendim eshte vertetuar edhe me vendimin e Gjykates se Apelit te Kosoves me nr. CA nr.545/13 date 19.06.13.

Andaj gjykata krejt ne fund pas vertetimit te tille te gjendjes faktike me prova ne procedure te ofruara nga pala paditese, deklarimi I paleve ndergjyqese gjeti se nuk ka baze ligjore per anulimin e kesaj kontrate per privatizimin e baneses siq pretendon pala paditese sepse ajo nuk arriti qe kete ta deshmoj me prova dhe ta bind gjykaten se ai ka te drejte mirepo nga provat e ofruara nga I padituri I pare M.P.gjykata u bind se ai ka te drejte, I njejti ka lidhur kontrate per shit-blerjen e baneses-privatizimin e saj conform LMD-se dhe nuk ka baze per anulimin e kontrates sipas nenit 103 dhe kjo kontrate e lidhur nuk permban asnje rrethane qe do te kishte ndikuar qe ajo te jet e lidhur ne kundershtim me dispozitat imperative dhe me rendin juridik apo te jet marre ne baze te diskriminimit.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedures gjykata mori conform nenit 449.1, 450, 452.1, 453.1 dhe me ate rast e obligoi palen paditese qe tja paguaj te paditurit te pare dhe gjykates Shumen prej 85 euro per shpenzimet dhe ate 50 euro per shpenzimet e udhimit e te paditurit M.P.dhe 35 euro per takse gjyqsore.

Nga sa u tha me larte u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE-DEGA PODUJEVE**  
**C.nr.471/10 me daten 25.02.2014**

**Gjyqtari:**  
Binak Duqi

**KESHILLA JURIDIKE:**

Kunder këtij aktgjykimi eshte e  
lejuar ankesa në afat prej 15 ditesh në  
Gjykaten e Apelit ne Prishtine, e nepermes  
kesaj gjykate.